



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 152, Datë 13.06.2022

MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 15, DATË 31.01.2019,  
“MBI LICENCIMIN NË AKTIVITETIN E TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR,  
TË TRANS ADRIATIC PIPELINE AG ALBANIA, E RREGJISTRUAR PRANË  
QKB, SI DEGË E SHOQËRISË SË HUAJ AKSIONARE (SH.A.), TRANS ADRIATIC  
PIPELINE AG”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 4, pika 50, nenit 35, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 3, pika 1, gërma “a” dhe nenit 113, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, miratuar me ligjin nr. 44/2015; ligjit nr. 107/2021 “Për Bashkëqeverisjen”; nenit 9, pika 1, gërma “e”, iv, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 97, datë 04.07.2017, e ndryshuar; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.06.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 910/1 prot., datë 10.06.2022, të përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s, “Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 15, datë 31.01.2019, “Mbi licencimin në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, të TRANS ADRIATIC PIPELINE AG ALBANIA, e rregjistruar pranë QKB, si degë e shoqërisë së huaj aksionare (sh.a.), TRANS ADRIATIC PIPELINE AG”, i ndryshuar”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendim nr. 15, datë 31.01.2019, “Mbi licencimin në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, të Trans Adriatic Pipeline Ag Albania, e rregjistruar pranë QKB, si degë e shoqërisë së huaj aksionare (sh.a.), Trans Adriatic Pipeline AG”, i ndryshuar, ndër të tjera ka vendosur që: shoqëria të paraqesë në ERE dokumentacionin e plotë që tregon titujt e pronësisë mbi asetet që ka për të kryer funksionet ose plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar në territorin e Shqipërisë.
- ERE ka pasur një korrespondencë me shoqërinë “Trans Adriatic Pipeline Ag Albania” (TAP AG Albania), lidhur me përmbushjen nga TAP AG Albania të kushtit të përcaktuar në pikën 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 15 datë 31.01.2019, i ndryshuar, ku ka kërkuar nga shoqëria plotësimin e këtij kushti.

- Shoqëria “Trans Adriatic Pipeline Ag Albania”, nëpërmjet shkresës me Nr. i Reference të TAP-it: LT-TAP-ERE-00038, të datës 11.04.2022, ka deklaruar se ka siguruar një pjesë të servitudit dhe pronësisë së tokës për strukturat mbitorësore nëpërmjet marrëveshjeve vullnetare dhe pjesa e mbetur e të drejtave të pronësisë dhe të servitudit, të fituara nëpërmjet procesit të shpronësimit, i kanë kaluar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe më pas do t'i transferohen TAP-it (në zbatim të gërmave (h) dhe (i), Pjesa 2, Shtojca 1 e Marrëveshjes me Qeverinë e vendit Pritës (MQP-së)). Gjithashtu shoqëria shprehet se ka siguruar tashmë të gjitha të drejtat mbi tokën dhe është në përfundim të procesit të regjistrimit të këtyre të drejtave pranë drejtorive përkatëse vendore të kadastrës, një proces i cili, për shkak të kompleksitetit, nuk ka përfunduar ende.
- Shoqëria TAP AG, nëpërmjet kësaj shkrese ka kërkuar, shtyrjen e afatit të përmbushjes së kushtit në pikën 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 15, datë 31.01.2019 “Mbi licencimin në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, të Trans Adriatic Pipeline Ag Albania, e rregjistruar pranë QKB, si degë e shoqërisë së huaj aksionare (sh.a), Trans Adriatic Pipeline AG”, i ndryshuar, me të paktën 24 muaj. Duke marrë në konsideratë llojet e ndryshme të të drejtave të pronësisë që TAP-i zotëron dhe duke ditur së dorëzimi i kopjeve të printuara origjinale ose të noteruara për dokumentacionin e pronësisë, është një volum i kosiderueshëm dokumentacioni, shoqëria ka kërkuar që ERE ta rishikojë kërkesën për dorëzim të dokumentacioni në format të printuar.
- Për sa kërkuar nga shoqëria dhe në lidhje me formën ligjore të këtij dokumentacioni, ligji nr. 107/2021 “Për bashkëqeverisjen”, në nenin 61, pika 1, “Sistemi i Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik (SQDNE)” parashikohet se: “Ofrimi i shërbimeve nga të gjitha institucionet shërbim ofruese, aplikimet e të cilave realizohen nëpërmjet platformës “e-Albania”, do të realizohet vetëm elektronikisht duke siguruar lëshimin e dokumentit përfundimtar me vulë elektronike ose nënshkrim elektronik”. Sa më sipër parashikuar në lidhje me lëshimin e dokumenteve zyrtare, përcaktohet se ato janë të vlefshme kur përmbajnë vulë ose nënshkrim elektronik. Në dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 8, pika 6, gërma “b” të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e gazit natyror”, e ndryshuar, parashikohet që dokumentacioni paraqitet në një kopje të printuar dhe në një format elektronik. Në zbatim të gjithë sa më sipër, për shkak se dokumentacioni pronësor sikurse referuar dhe nga shoqëria është voluminoz, ky dokumentacion mund të depozitohet në format elektronik (me CD), brenda 24 muajve me kusht që të jetë vulosur ose lëshuar elektronikisht në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr. 107/2021.
- Gjithashtu shoqëria TAP AG sugjeron që të shqyrtohet mundësia e ndryshimit të vendimit të bordit të ERE-s për Licencën e Transmetimit, duke hequr kushtin e parashikuar në pikën 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 15, datë 31.01.2019, “Mbi licencimin në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, të Trans Adriatic Pipeline Ag Albania, e rregjistruar pranë QKB, si degë e shoqërisë së huaj aksionare (sh.a), Trans Adriatic Pipeline duke argumentuar se:
  - Kur marrëveshjet vullnetare nuk kanë qenë të mundura, të gjitha të drejtat e pronësisë janë siguruar në bashkëpunim dhe me mbështetjen e MIE-s. Mbi këtë bazë dhe në kuadër të

dispozitive të MQP-së, MIE e ka pajisur TAP-in me Çertifikata Përdorimi për të gjitha seksionet e gazsjellësit dhe strukturat e tij përkatëse, çka garanton se të drejtat mbi tokën janë siguruar dhe se TAP-i mund ta operojë gazsjellësin.

- Gjithashtu, TAP informon se në Greqi, Rregullatori Grek i Energjisë (RAE) nuk ka kërkuar dokumentacion pronësie nga TAP-i gjatë procesit të aplikimit për Licencën e Operimit të Sistemit të Pavarur të Gazit Natyror (Licenca e Operimit INGS), e cila i është dhënë TAP-it me Vendim të RAE-s Nr. 752/2020 “Për dhënien e Licensës së Operimit (INGS) të Sistemit të Pavarur të Gazit Natyror për TAP AG lidhur me segmentin e TAP-it që përshkon Greqinë”. Këto të drejta janë siguruar nëpërmjet miratimit të Akteve për Instalimet nga Ministria Greke e Mjedisit dhe Energjisë dhe me RAE-n nuk ka pasur shkëmbim dokumentacioni që vërteton të drejtat e pronësisë.
- Në lidhje me këtë kërkesë, për heqjen e plotë të kushtit të përcaktuar në pikën 2 të dispozitivit të vendimit të bordit të ERE-s nr. 15, datë 31.01.2019, “Mbi licencimin në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, të Trans Adriatic Pipeline Ag Albania, e rregjistruar pranë QKB, si degë e shoqërisë së huaj aksionare (sh.a), Trans Adriatic Pipeline AG”, i ndryshuar, sqarojmë se ky kusht përmban një nga dokumentacionet që duhet të depozitohet një subjekt që kërkon të licencohet në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror dhe nuk mund të hiqet, përveçse kur të nisë një procedurë për rishikimin e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e gazit natyror” e ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të ndryshojë pikën 2 të dispozitivit të vendimit të bordit të ERE-s nr. 15, datë 31.01.2019, “Mbi licencimin në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, të Trans Adriatic Pipeline Ag Albania, e rregjistruar pranë QKB, si degë e shoqërisë së huaj aksionare (sh.a), Trans Adriatic Pipeline AG”, i ndryshuar, si më poshtë:

Bëhet:

*2. Jo më vonë se data 01.07.2024, shoqëria të paraqesë në ERE dokumentacionin e plotë, që tregon titujt e pronësisë mbi asetet që ka për të kryer funksionet ose plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar në territorin e Shqipërisë, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 107/2021 “Për Bashkëqeverisjen”.*

2. Drejtoria e Gazit Natyror, të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime

materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**